

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N.H. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me autorizim A. V., avokat nga Mitrovica, kundër të paditurit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina.” Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim S. Th., nga Prishtina, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 4680/2014, datë 20.10.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 5.4.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr. 4680/2014, datë 20.10.2015, në pjesën që ka të bëjë me anulimin si jo ligjor të vendimit të rektorit të të paditurit UP “Hasan Prishtina” Prishtinë, me numër protokolli ... datë ... dhe me obligimin që i padituri ta kthejë paditësin në detyrat e punës së dekanit të Fakultetit, me të gjitha të drejtat mbi bazë të punës, llogaritur nga shkarkimi, përkatësisht data 18.12.2013, deri në skadimin e mandatit më datë 1.10.2016, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i vendimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Prishen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë që ka të bëjë me atë që paditësit t’i njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe me obligimin e të paditurës për t’ia kompensuar shpenzimet e procedurës në shumë prej 270.40 €.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr. 4680/2014, datë 20.10.2015, është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr. 468/2014, datë 29.8.2014, në pjesën I të dispozitivit, ashtu që i padituri Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” është obliguar që paditësin N. H. ta kthejë në detyrat e punës së Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë me të gjitha të drejtat mbi bazë të punës, duke filluar nga shkarkimi, përkatësisht data 18.12.2013, deri në skadimin e mandatit më datë 1.10.2016, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i vendimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. Në pjesën II të dispozitivit është vërtetuar pjesa tjetër e aktgjykimit të sipërpërmendur, ndërsa ankesa e të paditurës është refuzuar si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale (neni 214 par. 1 pika (b) e

LPK), me propozimin që aktgjykimi i goditur të ndryshohet ashtu që e paditura të obligohet që paditësit t'ia kompensojë mjetet materiale për pozitën e Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, duke filluar nga shkarkimi, përkatësisht data 18.12.2013 deri te skadimi i mandati sipas zgjedhjeve të parakohshme.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi:

Revizioni është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me vendimin nr. 3/524, datë 18.12.2013, rektori i UP "Hasan Prishtina" ka shkarkuar nga pozita e dekanit të Fakultetit të Mjekësisë Prof.As.Dr.N. H., këtu paditësin, me arsyetimin se gjatë periudhës së menaxhimit nga ana e tij e këtij Fakulteti, ka pasur ngecje dhe të meta të theksuar menaxhimi në çështje të ndryshme akademike, organizative etj. Paditësi i është drejtuar me ankesë Këshillit Drejtues të UP, i cili ka konsideruar se Këshilli Drejtues autorizon Senatin e UP-ës ta shqyrtojë ankesën dhe, lidhur me këtë, të japë përgjigje me shkrim. Senati i UP-ës nuk e ka shqyrtuar ankesën, por me vendimin nr. 216 datë 22.01.2014, ka ndërmarrë masa lidhur me tejkalimin e situatës së krijuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka gjetur se vendimi për shkarkimin e paditësit është marrë nga organi jo kompetent dhe me shkelje të dispozitave të përcaktuara në Statutin e UP-ës, pastaj e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, e ka aprovuar pjesërisht qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ashtu që aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar në pjesën I të dispozitivit dhe e ka obliguar të paditurin ashtu siç përshkruhet në hollësi në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancave më të ulëta, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i goditur përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante, të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike.

Pretendimet e cekura në revizion se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuar, ngase në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret me të cilin do të argumentohet se cila dispozitë e ligjit është zbatuar në mënyrë të gabuar, ndërsa neni i përmendur 214 par. 1 pika (b) e LPK i parashikon vetëm shkaqet e paraqitjes së revizionit.

Qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta, si të drejtë dhe të bazuar në ligj, e pranon edhe kjo Gjykatë, ngase vendimi për shkarkimin e dekanit të Fakultetit të

Mjekësisë, këtu paditësit. është marrë në kundërshtim me Statutin e UP-ës, siç me të drejtë kanë konstatuar edhe gjykatat e mësipërme në aktgjykimet e tyre. Në nenin 28 të Statutit nuk është parashikuar kompetenca e rektorit për shkarkimin e dekanit, ndërsa në nenin 70 par. 4 të Statutit parashikohet që vendimi për shkarkimin e dekanit merret nga Senati, pasi të jetë konsultuar Këshilli i fakultetit përkatës, me shumicën e kualifikuar prej 2/3 të anëtarëve.

Në revizion është paraqitur një kronologji e gjithë procedurës së rastit konkret, por nuk është vënë në dukje asnjë rrethanë me të cilën do të vihej në dyshim ligjshmëria e aktgjyimit të kundërshtuar.

Gjykata i shqyrtoi pretendimet e ngritura në revizion, sipas të cilave kthimi i paditësit në postin e dekanit do të prodhonte efekte juridike të dëmshme dhe vargore të animimit nga menaxhmenti aktual i Fakultetit të Mjekësisë, por konstatoi se ato nuk mund të ndikojnë që gjykata të marrë një vendim tjetër, ngase objekt shqyrtimi para gjykatës ka qenë ligjshmëria e aktvendimit për shkarkimin e paditësit nga posti i dekanit, ndërsa sipas nenit 2 të LPK, gjykatat vendosin brenda kërkesave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitën ligjore të parashikuar nga neni 215 të LPK, kjo Gjykatë gjeti se ai nuk përmban shkelje thelbësore të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat i vëren sipas detyrës zyrtare.

Ndërkaq, sa i përket pjesës që ka të bëjë me njohjen e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, tani për tani gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjyimit, kështu që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta në këtë pjesë u prishën dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme vlerësoi se pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë me atë që paditësit t'i njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, është e paqartë dhe e papërmbarueshme, ngase nuk mund të kuptohet se cilat të drejta dhe detyra nga marrëdhënia e punës duhet t'i njihen paditësit, prandaj në këtë drejtim duhet të kërkohet prej tij që ta precizojë kërkesëpadinë e pastaj të merret një vendim i ligjshëm.

Për faktin që lidhur me një pjesë të aktgjytimeve të gjykatave të instancave më të ulëta revizioni u refuzua si i pabazuar, kurse një pjesë tjetër e aktgjyimit u kthye për rigjykim, nuk mundi të ndryshohej as kërkesa e palëve lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, prandaj u desh që aktgjykimet edhe në këtë pjesë të prishen, kështu që gjykata duhet të vendosë në rigjykim në bazë të kërkesës së palëve dhe provave të prezantuara që kanë të bëjnë me shpenzimet e bëra.

Nga sa u parashtrua dhe me zbatimin e neneve 222 dhe 224 par. 2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Rev.nr.70/2016, më 5.4.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku